



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Më 13 maj 2014  
Nr.ref.: MM630/14

**Rasti nr. KI89/13**

Parashtrues

**Arbresha Januzi**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së  
Aktgjykit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 74/2011,  
të 12 marsit 2013**

**Mendim Mospajtues**

**i gjyqtarëve Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi**

Ne mirëpresim aktgjykimin e shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: aktgjyki i shumicës). Megjithatë, me gjithë respektin, ne nuk mund të pajtohem me atë për arsyet që vijojnë më poshtë.

Në të vërtetë, sipas mendimit tonë, aktgjykimi i shumicës i kishte tejkaluar kornizat e kërkesës (I) dhe nuk i ka përbushur parimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) lidhur me vendimet kundërthënëse të gjykatave të rregullta (II), përkatesisht, në lidhje me çështjen (a) nëse ekziston një dallim, (b) nëse dallimet e thella dhe të kahershme ekzistojnë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, (c) nëse ligji vendas parashikon mekanizëm për tejkalinin e këtyre dallimeve dhe, nëse është kështu, (d) nëse ky mekanizëm është zbatuar dhe nëse po, në çfarë mase. Përveç kësaj, aktgjykimi i shumicës konsideron se pretendimet i tejkalojnë kornizat e kërkesës (III). Nuk do ta zgjasim shumë dhe do të kalojmë drejtpërdrejtë në tri temat e përmendura kryesore.

## Përtej kornizave të kërkësës

1. Pas dorëzimit të kërkësës së saj më 19 qershor 2013, parashtruesja e kërkësës dorëzoi pretendime dhe argumente shtesë, më 3, 6, 17 dhe 23 shtator 2013.
2. Duke i marrë parasysh të gjitha, aktgjykimi i shumicës thekson se parashtruesja e kërkësës pretendon që Aktgjykimi Rev. nr. 74/2011 i Gjykatës Supreme, i 12 marsit 2013, “*i ka shkelur të drejtat themelore të parashtrueses së kërkësës, të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]; nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], posaçërisht shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së*”.
3. Kështu, parashtruesi pretendon kryesisht dy shkelje: të drejtën e saj të punës dhe ushtrimit të profesionit (neni 49 i Kushtetutës) dhe të drejtën e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së).
4. Ne pajtohemi me Aktgjykimin e shumicës, i cili thekson se “*Një ankesë është e karakterizuar nga faktet e pretenduara në të dhe jo thjesht nga bazat ligjore apo argumentet në të cilat mbështetet*” (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së në Rastin *Ştefanica* dhe të tjerët kundër *Rumanisë*, i 2 nëntorit 2010, para. 23).
5. Megjithatë, faktet e pretenduara në kërkësë nuk janë të mjaftueshme për bazat juridike dhe argumentet e ndërtuara me aktgjykimin e shumicës. Prandaj, bazat juridike apo argumentet e mbështetura me aktgjykimin e shumicës nuk mund të shkojnë përtej fakteve të pretenduara në kërkësë.
6. Në të vërtetë, aktgjykimi i shumicës tejkaloj kornizat e kërkësës, konkretisht duke shqyrtau pretendimin e paqëndrueshëm lidhur me dallimet diskriminuese në trajtimin e parashtrueses së kërkësës dhe mungesës së arsyetimit të aktgjykimit.

### I. Parimet lidhur me vendimet kundërthënëse të gjykatave të rregullta

7. GJEDNJ (Shih, *Iordan Iordanov* dhe të tjerët, cituar më lart, par. 49-50) përcaktoi kriteret për vlerësimin e kushteve në të cilat vendimet kundërthënëse të gjykatave të ndryshme të vendit në shkallën e fundit janë në kundërshtim me kriteret e gjykit të drejtë, të mishëruara në nenin 6.1 të Konventës.
8. Në bazë të këtyre kritereve, vërtetohet nëse ekzistojnë dallime të thella dhe të kahershme në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit, nëse ligji i vendit parashikon mekanizëm për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve, nëse ky mekanizëm është zbatuar dhe, nëse po, deri në çfarë mase.
9. Aktgjykimi i shumicës i pranon këto kritere. Megjithatë, sipas mendimit tonë, këto kritere janë keqinterpretuar dhe zbatuar gabimisht me aktgjykimin e shumicës.

### **a) Nëse ka një dallim**

10. Në përgjithësi, secili rast është rast individual dhe si i tillë është i pandashëm. Në rastin në shqyrtim, ose dallimi i pretenduar ka të bëjë me rastet e mëparshme dhe do të ishte vetëm një rast që ndryshon ose dallimi i pretenduar ka të bëjë me një rast të nxjerrë tre (3) muaj më vonë dhe një gjë e tillë nuk mund të ishte paraparë. Sidoqoftë, rasti është i ndryshëm dhe do të duhej pritur një vendim ndryshe.
11. GJEDNJ konstaton se nuk mund të konsiderohet se trajtimi i ndryshëm shkakton praktikë gjyqësore kundërthënëse, kur kjo justifikohet me një dallim të situatave të përmendura faktike (shih, *Erol Ucar kundër Turqisë* (vendim), nr. 12960/05, 29 shtator 2009). Pra, le të krahasojmë situatat faktike në fjalë, në mënyrë që të shihet nëse ka ndonjë dallim.

### **Situata faktike në rastin e parashtrueses së kérkesës (Aktgjykimi Rev nr. 74/2011 i Gjykatës Supreme, të 12 marsit 2013)**

12. Më 17 maj 2005, parashtruesja e kérkesës pretendohet të ketë kryer vepër penale në objektin e vendit të punës. Kur kjo u zbulua, parashtruesja e kérkesës është njoftuar se kontrata e saj e punës është ndërprerë, bazuar në nenin 13 të kontratës së punës dhe nenin 11.3 (ndërprerja e kontratës së punës për raste të rënda të sjelljes së keqe) i Ligjit Themelor të Punës (Rregullorja e UNMIK-ut. 2001/27).
13. Më 25 gusht 2005, parashtruesja e kérkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke pretenduar se, sipas procedurave ligjore të aplikueshme, punëdhënësi duhej të kishte pezulluar ndërprerjen derisa të kishte përfunduar procedura penale. Parashtruesja e kérkesës gjithashtu parashtroi se rastet e rënda të sjelljes së keqe kanë të bëjnë me pronën e punëdhënësit dhe jo me pasurinë e personave të tretë, siç ishte rasti në situatën e saj; prandaj, sipas mendimit të saj, ndërprerja e punësimit ishte e paligjshme.
14. Më 10 tetor 2005, parashtruesja e kérkesës u shpall fajtore dhe u dënuia me pagesën e një gjobe prej 350 euro për veprën penale të pretenduar.
15. Më 19 dhjetor 2007, Gjykata Komunale vendosi që ndërprerja e kontratës së parashtrueses së kérkesës ishte e paligjshme, pasi që rastet e rënda të sjelljes së keqe kanë të bëjnë vetëm me pronën e punëdhënësit dhe jo të personave të tretë siç ishte rasti në situatën e parashtrueses së kérkesës; punonjësi është përgjegjës vetëm për shkeljet e detyrave të punës.
16. Më 30 dhjetor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë refuzoi ankesën e punëdhënësit, me arsyetimin që kontrata e marrëdhënies së punës të parashtrueses së kérkesës ishte ndërprerë menjëherë, në pajtim me nenin 13 të kontratës së punës dhe nenin 11.3 të Ligjit Themelor të Punës, sepse parashtruesja e kérkesës kishte kryer veprën penale ashtu siç pretendohet.
17. Më 12 mars 2013, Gjykata Supreme aprovoi revizionin e punëdhënësit dhe i ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës Komunale dhe të Qarkut për shkak se me nenin 11.3 (e), të Ligjit Themelor të Punës parashihej se “*kontrata e punës mund të*

*shkëputet në rastet e sjelljes së natyrës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritet vazhdimi i marrëdhënies së punës edhe më tej. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, vjedha në vend të punës cilësohet si sjellje e keqe e natyrës së rëndë pas së cilës do të ishte i paarsyeshëm vazhdimi i marrëdhënies së punës së paditëses [parashtrueses së kërkesës], kjo nga fakti se sjellja e keqe e vë në dyshim integritetin e saj moral që të kryejë ato punë, kjo reflekton edhe te punëtorët e tjerë si dhe në imazhin e të paditurës [punëdhënësit] ....”*

**Situata faktike në rastin e kolegëve të parashtrueses së kërkesës (Aktgjykimi Rev. nr. 32/2013, të Gjykatës Supreme, të 30 korrikut 2013)**

18. Më 17 dhjetor 2008, punonjës tjerë të punëdhënësit kryen vepër penale të ngjashme në objektin e vendit të punës. Kur kjo u zbulua, punëdhënësi mori vendimin e 23 dhjetorit 2008, për ndërprerjen e kontratës së punës, të të dy punonjësve.
19. Më 10 maj 2012, Gjykata Komunale aprovoi padinë e kolegëve të parashtrueses së kërkesës dhe vërtetoi se vendimi i punëdhënësit, i 23 dhjetorit 2008 ishte i pavlefshëm. Gjykata Komunale gjeti se punëdhënësi kishte zbatuar gabimisht dispozitat e nenit 11 dhe 11.5 të Ligjit Themelor të Punës siç thirren kolegët e parashtrueses së kërkesës, pasi ata nuk ishin njoftuar me qëllimin e përfundimit të marrëdhënies së tyre të punës. Për më tepër, njoftimi duhej të kishte përfshirë arsyet për ndërprerjen dhe duhej të ishin respektuar dispozitat e Rregullores për Politikat e Personelit të Aeroportit, pasi që, në pajtim me nenin 10, Komisioni Disiplinor duhej të kishte zhvilluar procedurën disiplinore [Rregullorja ende nuk ishte në fuqi në kohën e ngjarjeve në rastin e parashtrueses së kërkesës].
20. Më 23 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut i kishte pranuar të gjeturat faktike dhe qëndrimin juridik të Gjykatës Komunale, e refuzoi si të pabazuar ankesën e punëdhënësit dhe konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale duke konstatuar se ai nuk përbante asnjë shkelje.
21. Më 30 korrik 2013, Gjykata Supreme, në një përbërje të ndryshme të gjyqtarëve, nga ajo në rastin e parashtrueses së kërkesës, vërtetoi vendimet e gjykatave më të ulëta me të cilat ishte refuzuar padia e punëdhënësit, duke theksuar se, në mënyrë që të ndërpritet kontrata e punës në bazë të nenit 11.3 të Ligjit Themelor të Punës, përderisa në Ligjin e njëjtë, në nenin 11.5, parashihet që punëdhënësi duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin për qëllimin e tij të ndërprerjes së kontratës së punës dhe të përfshijë shkaqet për ndërprerjen, si dhe të ketë edhe një takim me punonjësit për të shpjeguar me gojë arsyet e tillë.
22. Gjykata Supreme më tej konsideroi se punëdhënësi i kishte nxjerrë vendimet në formë të shkruar dhe ua kishte dorëzuar kolegëve të parashtrueses së kërkesës pa ndjekur procedurat e duhura, të parapara me ligj. Gjykata Supreme gjithashtu iu referua nenit 8.3 të Rregullores së Politikave të Personelit të Aeroportit, të 26 qershorit 2005, sipas të cilit, punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën pa paralajmërim ose kompensim, në rast se konsideron se ka bazë të mjaftueshme për ta bërë këtë, siç është mungesa serioze e disiplinës, performansa e vazhdueshme jo e plotë dhe në mospërputhje me detyrat apo

shkelje të rënda profesionale. Baza e tillë e mjaftueshme për ndërprerje do të duhet të përcaktohet nga Komisioni Disiplinor, puna e të cilit rregullohet me nenin 10 të Rregullores.

23. Gjykata Supreme konsideroi se asnjëra nga këto procedura nuk ishte respektuar në rastin e kolegëve të parashtrueses së kërkesës.

### **Krahasimi i të dy rasteve**

24. Siç përcaktohet më sipër, situatat faktike në rastin e parashtrueses së kërkesës dhe në rastin e kolegëve të parashtrueses së kërkesës nuk janë identike për arsyet si në vijim.
25. Sipas parashtresave të parashtrueses së kërkesës, ndryshe nga kolegët e saj, parashtruesja e kërkesës ka qenë e shpallur fajtore dhe e dënuar për veprën penale të pretenduar gjatë procedurës së filluar nga parashtruesja e kërkesës për ndërprerjen e paligjshme të kontratës.
26. Për më tepër, duket se parashtruesja e kërkesës, ndryshe nga kolegët e saj, nuk është thirrur në nenin 11.5 të Ligjit të Punës në procedurën pranë Gjykatës Komunale, të Qarkut dhe të Gjykatës Supreme, por i ka bazuar argumentet e saj në nenin 11.3 të Ligjit, i cili flet për vjedhjen e "pasurisë së punëdhënësit" "dhe jo për vjedhjen e pasurisë së një" *"personi të tretë"*, siç ndodhi në rastin konkret.
27. Pra, rasti i kolegëve të parashtrueses së kërkesës nuk bazohet në argumete të ngjashme, të përdorura nga parashtruesja e kërkesës në rastin e saj, por ekskluzivisht në nenin 11.5 të Ligjit.
28. Prandaj, ne konstatojmë se rasti i parashtrueses së kërkesës dhe ai i kolegëve të parashtrueses së kërkesës nuk janë identikë; edhe në qoftë se ata do të ishin identikë, ata nuk do të nënkuptionin shkelje, siç shpjegohet më tej.

#### **b) Nëse ekzistojnë "dallime të thella dhe të kahershme", në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme**

29. Në rastin e *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, nr. 13279/05 të 20 tetorit 2011, Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së ka përcaktuar parimet e përgjithshme që vlejnë në ato raste (para. 49-58). GJEDNJ-ja ka theksuar, *inter alia*:

*"50. [...] përveç në rast të arbitraritetit të dukshëm, nuk është roli i Gjykatës që të vërë në pikëpyetje interpretimin e të drejtës vendore nga gjykatat shtetërore (shih, për shembull Ādamsons kundër Letonisë, nr. 3669/03, para. 118, 10 maj 2007). Ngjashëm, në këtë kuptim, parimisht nuk është funksioni i saj që të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse janë nxjerrë në procedura dukshëm të ngjashme; gjykata duhet të respektojë pavarësinë e atyre gjykatave (shih Engel dhe të tjerët kundër Holandës, 8 qershor 1976, para. 103, Seria A nr. 22; Gregório de Andrade kundër Portugalisë, nr. 41537/02, para. 36, 14 nëntor 2006; dhe Ādamsons, cituar si më lart, para. 118).*

*58. Megjithatë, Gjykata thekson që dispozitat e sigurisë juridike dhe mbrojtjes së besimit legjitim publik nuk përbëjnë të drejtë të fituar ndaj konsistencës së praktikës gjyqësore (shih Unédic kundër Francës, nr. 20153/04, para. 74, 18 dhjetor 2008) [...].*

30. Me rastin e arritjes së përfundimit të tij, aktgjykimi i shumicës është mbështetur në interpretimin e dhënë të fakteve dhe të ligjit në një Aktgjykim të Gjykatës Supreme, ku pretendohet që situata të jetë identike me atë të parashtrueses së kërkesës.
31. Megjithatë, aktgjykimi i shumicës bazohet në mospërputhjen e pretenduar ndërmjet Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 74/2011, i 12 marsit 2013) dhe të atij në rastin e kolegëve të parashtrueses së kërkesës, të nxjerrë katër (4) muaj më vonë (Aktgjykimi Rev. nr. 32/2013 i Gjykatës Supreme, i 30 korrikut 2013). Në këtë drejtim, iu referohemi paragrafëve 44 dhe 45 të aktgjykimit të shumicës si më poshtë: “*44. Sipas parashtrueses, Gjykata Supreme, vetëm pak muaj pas rastit të saj, nxori Aktgjykimin Rev. nr. 32/2013, me të cilin është aprovuar, si e bazuar kërkesëpadia e dy të punësuarave tjera, në rrethana tërësisht të njëjta si të parashtrueses. 45. Gjykata Kushtetuese, pas gjetjeve nga shkresat e lëndës, vëren se Aktgjykimi Rev. nr. 74/2011 (rasti i parashtrueses) dhe Rev. nr. 32/2013 (rasti i dy të punësuarave tjera) për nga baza ligjore e aplikuar, faktet dhe provat janë plotësisht të njëjta*”.
32. Vërejmë se GJEDNJ-ja, në një sërë rastesh, është dashur të vendosë për implikimet e vendimeve kundërthënëse gjyqësore në të drejtën për gjykim të drejtë. Në disa nga këto raste të GJEDNJ-së, një numër i tyre ka të bëjë me vendime kundërthënëse të Gjykatave Supreme vendore.
33. Shumica e ka justifikuar vendimin e saj duke iu referuar Aktgjykimit të GJEDNJ-së në rastin *Beian kundër Rumanisë* (Nr. 1), (Nr. 30658/05, 6 dhjetor 2007).
34. Në rastin e parashtrueses së kërkesës, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është në kontrast me vetëm një Aktgjykim tjetër të Gjykatës Supreme, i cili ishte nxjerrë katër (4) muaj më vonë në rastin e kolegëve të parashtrueses së kërkesës lidhur me faktet e ngjashme të pretenduara, provat dhe ligjin.
35. Prandaj, në bazë të vetëm një Aktgjykimi të Gjykatës Supreme (Rev. nr. 32/2013), dhe, për më tepër, të nxjerrë katër (4) muaj më vonë në një përbërje tjetër të gjyqtarëve, është vështirë të kuptohet se si mund të konstatohet se ka dallime të thella dhe të kahershme në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, që rrezikojnë parimin e sigurisë juridike dhe, në këtë mënyrë, minojnë sundimin e ligjit. Është pothuajse logjikisht e pamundur të thuhet se ka një dallim të thellë dhe të kahershëm, kur kjo paraqitet vetëm në mes të dy aktgjykimeve apo vetëm të një grapi të aktgjykimeve dhe të një aktgjykimi tjetër.
36. Në të kundërtën, rasti *Beian kundër Rumanisë* ka të bëjë me përcaktimin e të drejtës për benefacione të veçanta sociale të ofruara me një ligj të ri për personat që ishin detyruar të kryenin një shërbim të detyrueshëm publik joushtarak në

vitet '50. Ligji përcaktonte që përfitues ishin personat që ishin angazhuar në shërbimin e detyrueshëm nën autoritetin e një agjencie të caktuar të quajtur DGT. Parashtruesi në atë rast kishte kryer shërbimin e detyrueshëm, por jo nën autoritetin e DGT-së. Gjatë periudhës 2003-2006, Gjykata Supreme e Rumanisë ishte ftuar të vendoste nëse personat që kishin kryer shërbimin e detyrueshëm, jo nën autoritetin e DGT-së, kualifikoheshin gjithsesi për beneficionet e përcaktuara me ligj. Gjatë kësaj periudhe kohore, Gjykata Supreme e Rumanisë kishte vodusur 18 herë në të mirë të personave që nuk ishin nën autoritetin e DGT-së, si dhe 17 herë në dëm të atyre personave. Nganjëherë, vendimet kundërthënëse nxirreshin gjatë të njëjtës ditë. GJEDNJ-ja ishte veçanërisht e brengosur që Gjykata Supreme vetë ishte kthyer në burim të pasigurisë juridike, duke marrë parasysh rëndësinë e rolit të Gjykatës Supreme në zgjidhjen e kundërthënieve në interpretimet gjyqësore.

37. Rasti *Beian kundër Rumanisë* ka të bëjë me një numër qenësor të vendimeve kundërthënëse të nxjerra nga Gjykata Supreme për një periudhë prej më shumë se tri (3) viteve, të cilat kalojnë pa dallim nga njëri interpretim në tjetrin. Numri i madh i rasteve në një periudhë të konsiderueshme kohore, me mungesë të plotë të konsistencës, janë faktorët që çojnë në gjetjen e arbitraritetit të dukshëm në atë rast. Mu kjo gjetje e arbitraritetit të dukshëm është ajo që çon në gjetjen e shkeljes së Nenit 6 (1) të Konventës.
38. Dallimi me rastin e tanishëm në shqyrtim, nga Gjykata Kushtetuese është i konsiderueshëm. Në të vërtetë, siç përmendet në aktgjykimin e shumicës në paragrafët 44 dhe 45, parashtruesja e kërkesës paraqiti vetëm detajet e një rasti të Gjykatës Supreme, që është nxjerrë katër (4) muaj më vonë dhe, për këtë arsy, parashtruesja e kërkesës nuk mund të kishte pasur njohuri për të në kohën e procedurës gjyqësore në rastin e saj. Megjithatë, madje edhe duke supozuar se rasti i parashtrueses së kërkesës mund të krahasohet me një rast të mëvonshëm, korniza kohore gjatë së cilës janë nxjerrë këto Aktgjykime të Gjykatës Supreme që pretendohen të jenë kundërthënëse, përfshin një periudhë të shkurtër prej katër (4) muajve dhe vetëm me dy aktgjykime në atë periudhë.
39. Interpretimi i të drejtës materiale nga Gjykata Supreme pretendohet të ketë genë ndryshe në të dy rastet. As numri i këtyre aktgjykimeve të pretenduara si kundërthënëse, dhe as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, nuk arrijnë nivelin e peshës apo pasigurisë juridike, të cilat do të arsyetonin përfundimin e arbitraritetit të dukshëm nga shumica dhe as të shkeljes pasuese të së drejtës së parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
40. Rrjedhimisht, ne nuk mund të pajtohem që dallimi i supozuar i interpretimeve juridike në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në rastin e parashtrueses së kërkesës, *vis-à-vis* aktgjykimit tjeter, të nxjerrë katër (4) muaj më vonë, demonstron "*dallimin e thellë dhe kahershëm*" në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme.

**c) Nëse ligji i brendshëm parashikon mekanizëm për tejkalimin e këtyre dallimeve**

41. Ne i përkujtojmë dy nga parimet më të përsëritura në vendimet e Gjykatës Kushtetuese.
42. Njëri prej parimeve është se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohen të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përvèç nëse ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Kështu, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta.
43. Tjetri parim është se arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'ua lejojë autoriteteteve në fjalë mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efikas juridik kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës.
44. Në rastin konkret, parashtresat e parashtrueses së kérkesës nuk tregojnë se, kur punëdhënësi parashtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut (që ishte në favor të parashtrueses së kérkesës), në ato procedura të revizionit, ajo bëri referencë të qartë në nenin 11.5 të Ligjit Themelor të Punës apo kishte përdorur argumente tjera, siç ishin përdorur nga dy punonjësit e tjerë në rastin e tyre apo të cilët ishin përdorur në rastet e mëparshme të paspecifikuara, të përmendura nga parashtruesja e kérkesës.
45. Për më tepër, Gjykata Supreme është kompetente për të unifikuar zbatimin e ligjeve dhe mund të thërrasë seancë të përgjithshme të të gjithë gjyqtarëve të saj për nxjerrjen e vendimeve që promovojnë zbatimin unik të ligjeve (Nenet 22. 1.3 dhe 23.1 të Ligjit për Gjykatat, nr. 03/L-199). Parashtruesja e kérkesës mund të ketë kérkuar që Gjykata Supreme të shqyrtojë rastin e saj, në përputhje me një kompetencë të tillë.
46. Në fund, theksojmë se Gjykatës Supreme nuk i është dhënë mundësia për të parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës, dhe as që kishte ngritur parashtruesja e kérkesës këtë çështje te ajo.

**d) Nëse ai mekanizëm është zbatuar dhe, nëse po, në çfarë mase**

47. Nuk ka asnjë tregues se parashtruesja e kérkesës para se të vinte në Gjykatë, ka përdorur ndonjë nga mjetet e siguruara nga mekanizmi i të drejtës vendore për të tejkaluar këto dallime.

**III. Pretendimet përtej kornizës së kérkesës**

**a) Dallimet diskriminuese në trajtim**

48. Siç u tha më lart, asnjë nga pretendimet lidhur me dallimet diskriminuese në trajtim, nuk ishin argumentuar dhe dëshmuar nga parashtruesja e kérkesës dhe kështu aktgjykimi i shumicës tejkaloj kornizat e kérkesës.

49. Megjithatë, me aktgjykimin e shumicës konsiderohet se ky dallim në aktgjykimin në rastin e parashtrueses së kërkesës, kundrejt rastit të kolegëve të parashtrueses së kërkesës, sollën trajtim të pabarabartë para ligjit në kundërshtim me nenin 24, par. 1, të Kushtetutës.
50. Neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës përcakton:
- “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gjëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”.*
51. Në pajtim me praktikën konsistente gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, i mbetet parashtrueses së kërkesës të demonstrojë se në çfarë mënyre ajo është trajtuar ndryshe, si dhe në çfarë bazash ka ndodhur ky dallim i pretenduar në trajtim (p.sh. *Fredin kundër Suedisë* (Nr. 1). Nr. 12033/86, 18 shkurt 1991, para. 60-61). Vetëm pasi të vërtetohet dallimi në trajtim, si dhe pasi të përcaktohet natyra e shkaqeve të këtij dallimi në trajtim, atëherë mund të testohet justifikimi për këtë trajtim ndryshe për nga arsyeshmëria dhe objektiviteti.
52. Parashtruesja e kërkesës nuk kishte argumentuar dhe dëshmuar asnjë diskriminim “*në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal*”.
53. Në të vërtetë, nuk ka asnjë pretendim dhe dëshmi që parashtruesja e kërkesës është trajtuar ndryshe për ndonjë arsyе lidhur me bazat e përmendura në nenin 24.2 të Kushtetutës dhe as nuk ka dëshmi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në lidhje me parashtruesen e kërkesës ishte, për ndonjë arsyе tjetër përveç sqarimit të Gjykatës së ligjit të aplikueshëm, diskriminues në kuptim të këtij nenit.
54. Prandaj, edhe në qoftë se pretendohet, nuk ka pasur shkelje të të drejtave të parashtrueses së kërkesës për barazi para ligjit ose mbrojtje e barabartë sipas ligjit, siç përcaktohet me nenin 24 të Kushtetutës.

### **b) Mungesa e arsyetimit të vendimit të Gjykatës Supreme**

55. Prapë se prapë, asnjë pretendim lidhur me mungesën e arsyetimit në vendim të Gjykatës Supreme nuk është argumentuar dhe dëshmuar nga parashtruesja e kërkesës, dhe, në këtë mënyrë, aktgjykimi i shumicës tejkaloi kornizat e kërkesës.

56. Një nga parimet që duhet zbatuar është që “*dispozitat e sigurisë juridike dhe mbrojtjes së besimit legjitim publik nuk përbëjnë të drejtë të fituar ndaj konsistencës së praktikës gjyqësore* (shih *Unedic kundër Francës*, nr. 20153/04, para. 74, 18 dhjetor 2008)“.
57. Sipas mendimit tonë, kapitulli i titulluar “*Mungesa e arsyetimit në aktgjykimin në rastin e parashtrueses së kërkesës dhe aplikimi i parimeve të përgjithshme për rastin konkret*” është i paqëndrueshëm, i palogjikshëm dhe i parëndësishëm..
58. Në të vërtetë, dështimi i Gjykatës Supreme të arsyetojë mund të kuptohet vetëm kështu:
- ose ka të bëjë me aktgjykimin e parashtrueses së kërkesës dhe Gjykata Supreme nuk ka mundur të vendosë në të ardhmen, në abstrakt, pasi që vendimi tjetër u mor vetëm katër (4) muaj më vonë;
  - ose ka të bëjë me grupin e aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të nxjerra para aktgjykimit të parashtrueses së kërkesës dhe Gjykata Supreme nuk është e detyruar të jep arsy, aq më tepër kur një argument nuk ka qenë i paraqitur dhe nuk ka të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore;
  - ose ka të bëjë me aktgjykimin e vetë rastit të parashtrueses së kërkesës dhe ka një arsyetim të detajuar dhe të qartë në atë Aktgjykim të Gjykatës Supreme.
59. Kështu, zbatimi, në rastin në fjalë, i parimeve të përgjithshme në lidhje me “*Mungesa e arsyetimit në Aktgjykim [...]*” është i paqëndrueshëm, i palogjikshëm dhe i parëndësishëm.

## Përfundim

60. Prandaj, ne nuk mund të pajtohem me aktgjykimin e shumicës, që geti shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe shkelje të së drejtës për barazi para ligjit dhe konkludojmë se Gjykata Kushtetuese ka vepruar si gjykatë e shkallës së katërt.

Dorëzuan me respekt,

Gjyqtari Almiro Rodrigues



  
Gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi